



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1865/2 prot.,

Datë 01.08.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË
OPERATORIT EKONOMIK ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN
E OFERTUESVE TË TJERË**

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “2AS INVEST” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar – Marrëveshje kuadër”, me Nr. REF-72694-06-15-2023, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 7.499.926 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike.

Skualifikimin e operatorit ekonomik “AlbaScan” SHPK, pasi nuk ka plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit, të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimimi.

Ankimues:

Operatori ekonomik “2AS INVEST” SHPK
Adresa: Lagjja 13, Plazh, Zona Kadastrale 8518, Nr. Pasurie 58/338+1-43, kati tetë, Durrës.

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “AlbaScan” SHPK
Adresa: Rruga “Barrikada”, Hyrja 1, Përballë Gjimnazit “Sami Frashëri”, Zona kadastrale 8360, Nr pasurie 5/351 Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia e Shërbimeve Publike
Adresa: Lagjja “Shkumbini”, Elbasan.

Në datën 31.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1865/2023 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/ 3321 e operatorit ekonomik

“2AS INVEST” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar – Marrëveshje kuadër”, me Nr. REF-72694-06-15-2023, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 7.499.926 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “2AS INVEST” SHPK, si dhe kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “AlbaScan” SHPK, pasi nuk ka plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit, të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “2AS INVEST” SHPK, e cila kundërshtohet në ankesën me nr. 1865/2023 protokolli, datë 31.07.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Në dokumentat standarte të tenderit është parashikuar që ofertimi nga operatorë ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Si rrjedhim, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur KVO konstatoi se ofertimi në formularët e paraqitur, shtojca 1 - Formulari i ofertës dhe shtojca 2 - Lista e çmimeve të artikujve është bërë me çmim total dhe jo me shumatoren e çmimeve për njësi, çka bie në kundërshtim me parashikimin e kriterit të vlerësimit, i cili do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi, prandaj dhe shtojca 1 - Formulari i ofertës dhe shtojca 2 - Lista e çmimeve të artikujve duhet të kishin si çmim të ofruar shumatoren e çmimeve për njësi.

Gjithashtu ju keni paraqitur një preventiv të veçantë të emërtuar shumatorja e çmimeve për njësi ku çmimi total i shumatores së çmimeve për njësi është 124,860 lekë pa tvsh, i cili edhe nëse do të merrej në konsideratë është mbi shumatoren e çmimeve për njësi të parashikuar në dst, e cila është 109,508 (njëqind e nëntë mijë e pesëqind e tetë) lekë pa tvsh dhe duke qenë se vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi, kjo vlerë konsiderohet mbi fondin limit.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se:

Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

2. Nuk përmbushni pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik, për arsye se: një nga mostrat e paraqitura nuk është në përputhje me specifikimet teknike e konkretisht:

Mostra e paraqitur për artikullin lampa Led 40w me reduktor nuk është në përputhje me specifikimet teknike pasi i mungon reduktori.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se:

Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

3. Nuk përmbushni pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik, për arsye se:

3.1. Keni paraqitur autorizim datë 23.06.2023 nga subjekti "ITE Group" SHPK, në të cilin, përcaktohet se: shoqëria "ITE Group" SHPK, si distributor i autorizuar për produktet e prodhuar nga Philips dhe Schneider Electric, autorizon subjektin "2AS INVEST" shpk të dorëzojë ofertën bazuar në produktet tona dhe rrjedhimisht të negociojë dhe të lidhi kontratën për tenderin me numër reference: REF-72694-06-15-2023 me objekt "Blerje materiale elektrike".

Bashkangjitur është paraqitur Letër Autorizimi datë 08.09.2020 me këtë përmbajtje:

Për këdo që është i interesuar,

Ne SCHNEIDER ELECTRIC BULGARIA EOOD, te cilet jemi dege e SCHNEIDER ELECTRIC INDUSTRIES SAS, prodhuesit zyrtar te Serive DOM , Easy9, IC40, Releve, Suporteve siguresave dhe siguresave dhe kontaktorve Acti9, me fabrika ne France,Hungari, Bullgari autorizojme kompanine:

Kompania: ITE Grup shpk

Adresa: Autostrada Tirane-Durres, km 5

NUIS: K11323001H

Me perfaqesues Ligjor Z. Sokol Zotkaj, te paraqese tenderin dhe me pas te negocioj dhe te nenshkruaj Kontraten.

Ne japim garanci te plote lidhur me Kushtet e Pergjithshme te Shitjes nga Schneider Electric, ne te mirat materiale te ofruara nga firma e mesiperme dhe te prodhuara nga Schneider Electric.

Nga përmbajta e kësaj letër autorizimi del qartë që SCHNEIDER ELECTRIC BULGARIA EOOD nuk e autorizon "ITE Grup" shpk si distributor, por e autorizon që të paraqesë ofertë në tender. Pra shoqëria "ITE Grup" shpk nuk është distributor i autorizuar për produktet e prodhuar nga Schneider Electric.

Sa mësipër, edhe produktet për të cilat keni paraqitur katalogët nga kompania Schneider Electric do të konsiderohen si të pa paraqitura e konkretisht: Perforcues sinjali, Automate 63 A 1 Polar, Automate 63 A 3 Polar dhe Automate 100 A 3 Polar.

3.2 Në katalogët e paraqitur për produktet llampa 80W me zhivë E-27, llampa 125 W me zhivë E-27 nuk përputhen me specifikimet teknike e konkretisht me jetëgjatësinë e produktit. Në specifikimet teknike për produktet llampa 80W me zhivë E-27 dhe llampa 125 W me zhivë E-27 jetëgjatësia është kërkuar min 18000 orë, ndërsa në katalogët e paraqitur për keto produkte jetëgjatësia është 16000 orë.

3.3 Për produktin "konektorë abonenti trefazorë" nuk keni paraqitur katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skeda teknike të prodhuesit/ve ne gjuhen e specifikuar ne njoftimin e kontrates, qe eshte gjuha shqipe, ne kundërshtim me parashikimet e dokumentave te tenderit ku thuhet shprehimisht: Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.

Për produktin "Kapak plastik per puseta plastike 40x40cm" keni paraqitur katalog i cili nuk është i prodhuesit nga i cili keni paraqitur autorizimin ne kundërshtim me parashikimet e pikës 2.3.6 të kapacitetit teknik ku thuhet shprehimisht: Ne rast se operatori ekonomik ofertues nuk eshte prodhues, ai duhet te paraqese, per artikujt e mesiperme per te cilat eshte kerkuar paraqitja e mostres autorizim nga prodhuesi ose distributori per mallin objekt prokurimi shoqëruar me katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skeda teknike të prodhuesit/ve, ku te dallohen qartë specifikimet teknike te saj.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se:

Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme."

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret të cilat operatori ekonomik ankimes “2AS INVEST” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “AlbaScan” SHPK pjesmarrës në procedurë.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “AlbaScan” SHPK, pjesmarrës në procedurë të kriterëve kualifikues si më poshtë vijon:

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. *Ofertuesi duhet të paraqesë:*

c. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

2.3.5. *Operatorët Ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi, duhet të paraqesin mostrat për elementet e mëposhtem sipas preventivit dhe specifikimeve të kerkuara në datën dhe orën e hapjes së tenderit në ambjentet e Drejtorisë së Prokurimeve Publike, ish Konvikti i Shkolles së Muzikës, kati tretë (date 27/06/2023 ora 10:00), konkretisht:*

Nr.	EMERTIMI
1	Llampa 80 W Me Zhive E-27
2	Llampa 125 W Zhive E-27
3	Llampa Led 40 w me reduktor
4	Llampa 250 W HQL me Zhive
5	Llampa 250 W hps sodium
6	Leshues 40w per shatervanet (pompat)
7	Pllaketa Led 100 W
8	Pllaketa Led 50w
9	Llampe sinjalizuese
10	Kondesatore 45 mikro(per pompat)
11	Konektore abonenti trefazore
12	Drozela 125 W
13	Drozela 250 W 3 A 220 V
14	Leshues 125 A
15	Leshues 150 A
16	Perforcues sinjali
17	Celes me Wifi dhe BLE me tre grupe
18	Kapak plastik per puseta plastike 40x40cm
19	Tirant ABC + Fasheta Shtylle
20	Automate 63 A 1 Polar
21	Automate 63 A 3 Polar
22	Automate 100 A 3 Polar

23	Percjelles i Veshur 6 mm
24	Percjelles i Veshur 10 mm
25	Kabell Bakri 3 * 2.5 mm
26	Kabell Bakri 4 * 10 mm
27	Kabell ABC 4 * 16 mm Al

Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.

2.3.6 Ne rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues, ai duhet të paraqesë, për artikujt e mesiperm për të cilat është kërkuar paraqitja e mostrës autorizim nga prodhuesi ose distributori për mallin objekt prokurimi shoqëruar me katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skeda tekniketë prodhuesit/ve, ku të dallohen qartë specifikimet teknike të saj. Ne rastin e autorizimit me distributorin të dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin.

Gjithashtu ankimuesi pretendon se oferta ekonomike e shoqërisë “AlbaScan” SHPK është anomalisht e ulët.”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 01.08.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri